

BAJRON – Kënga e lamtumirës

-Pyetje me shtjellim-

-shënime-

Kënga e lamtumirës është një nga më të famshmet e poemës dhe ngërthen thelbin e heroit romantik: vetminë, zhgënjimin, dëshirën për ikje, mallin e pesimizmin, lirinë si kërkesë të brendshme të qenies romantike etj.

Në ç'formë është ndërtuar kjo këngë?

Një nga tiparet romantike është paralelizimi i gjendjes shpirtërore të heronjve me gjendjen e natyrës.

Gjeni një rast në këngë për të ilustruar këtë tipar.

Dielli dhe atdheu në vargjet më poshtë lidhen në një pikë.

Cila është ajo?

Cilin tipar romantik mund të dallojmë të shprehur në këto vargje?

*Pas diellit që po flakëron
Po nisemi të lirë;
Dhe ty, si atij që perëndon,
Atdhe, natën e mirë!*

Cili është tipari thelbësor i pamjes që përcjellin vargjet e mëposhtme?

Çfarë ndjesie krijon kjo pamje?

*Në vatrën tima nuk ka zjarr,
Nëpër avllit e forta
Të kullës sime rritet bar,
Im qen po leh te porta.*

-shënime-

Përcaktoni rolin e pazhit duke u nisur nga fjalët që shkëmben Haroldi me të:

H – Ti pazh i vogël pa m'u qas

Pse qan e po vajton?

P – Prej babës e prej nënës ik

U ndava prej shtëpisë.

Tani s'më mbetet asnjë mik

Veç teje e perëndisë.

Po nënën kush ma ngushëllon

Gjer sa të kthehem gjallë?

Po kur kujtova gruan larg

M'u zbe faqja besnike.

H – Pusho, pusho, ti djal i mirë!

Të kanë hije lott;

Po të isha vetë zemërdëlirë

Nuk do t'i mbanja dot.

Çfarë e lidh heroin me atdheun e vet? A është e kuptueshme pse e braktis atë?

Kush u beson psherëtimave

Të femrës që mbush sytë?

Ja than lotët qepallave

Ndonjë dashnori dytë.

Do t'angullijë ndoshta sot

Im qen gjersa të gjejë

Ushqim nga ndonjë tjetër zot;

Nd'u kthefsha do më ç'qenjë.

Në kërkim të cilës liri niset heroi romantik, sipas vargjeve:

Të falem det i kaltr' i zi!

Dhe kur të shkel i lirë

Në dhe, të falem, shlretëti!

Atdhe, natën e mirë!

Vargjet kulmore të gjithë këngës përcjellin zhgënjimin nga realiteti. Analizojeni atë.

S'qaj për gëzimet që humbas,

Rrezikun që më vjen;

Po vetëm qaj se nuk le pas

Asnjë që lotn' e vlen.